

ZHVILLIMI I TURIZMIT NË RAJONIN MALESH-PIJANEC

HYRJE

Rajoni Malesh-Pijanec (komunat Berovë, Pehçevë, Dellçevë) shtrihet në fushën e Malishevës dhe Pijanecit. Përbën sipërfaqe prej 1228 km² dhe ka rreth 37 mijë banorë. Në territorin e rajonit gjenden tre qendra urbane: Berova, Dellçeva dhe Pehçeva dhe rreth 35 vendbanime fshatra.

Ky rajon ngadalë po kalon në listën e parë të vendeve më tërheqëse turistike në Maqedoni. Njohja bëhet kryesisht për shkak të bukurive natyrore, mjedis jetësor të pa ndotur dhe ushqim i shëndetshëm tradicional, që ofron ky vend vizitorëve. Megjithatë, rrethina Malishevë-Pijanec, si rrethinë e pastër dhe e pa ndotur, karakterizuar me pjesë të rralla natyrore unike të njohura si resurs nacional për zhvillim të turizmit alternativ dhe malor, ende nuk është kompetent që të mbajë turistët në periudhë më të gjatë kohore, për shkak të ofertës së kufizuar të argëtimit.

Besohet që të gjithë turistët, ato vendor dhe të huaj, vizitojnë vende të ndryshme për shkak të hulumtimit të veçorive që përfshijnë gjëra të ndryshme. Ashtu, mund të jenë në kërkim të: bukurive natyrore, arkitekturë, vende fetare ose përmendore, lloje të reja dhe të ndryshme të ushqimit dhe kulturë lokale.

Në këtë rajon ka nevojë për zgjerimin e ofertës tek turizmi kulturor që të mund të tërhiqen grupe të reja synimi që interesohen për manifestime kulturore, koloni artistike, natë të poezisë, etj., si dhe përmbajtje që përfshijnë shëtitje malore, ecje, biçikletë, për ata turistë që kanë nevojë për adrenalinë dhe kërkojnë diçka më tepër se pushim. Oferta më e pasur turistike do të mbante turistët më gjatë se një ditë. Me atë, edhe vendet e banuara të rajonit do të kenë dobi ekonomike nga turizmi, jo vetëm restorantet dhe kapacitetet e akomodimit.

Në këtë dokument të shkurtë theksojmë që me politika të caktuara dhe intervenime duhet të përmirësohen kushtet për zhvillim të turizmit në rajonin e Malishevës-Pijanecit, që do të kontribuojë edhe për trajtimin e disa problemeve kryesore të rajonit, si për shembull, migracionin, ikjen e të rinjve, ofertën e kufizuar për punësim dhe tjera.

ZBULIME KRYESORE

Trendi i migracionit të popullatës nga rajonet rurale në qytetet më të mëdha, si në Maqedoni ashtu edhe jashtë shtetit, është një problem që po merr përmasa shqetësuese, dhe më alarmante është numri i madh i qytetarëve që migrojnë janë persona të rinj me arsim të lartë. Kjo do të thotë që vendet rurale, dhe në përgjithësi shtetit, mbeten pa popullatën aktive që njohuritë dhe përvojat i përdorin në vende tjera, dhe jo atje nga e kanë origjinën. Për këtë, Shoqata e Bimëve Shëruese dhe Frutave të Malit “Ambrozija” në periudhën 2015-2016 ka zbatuar projektin “Me anë të veprimit të integruar për uljen e migracionit” me të cilin ishin shqyrtuar arsyet kryesore për migrim. Në kuadër të anketës së zbatuar me gjithsej 100 të anketuar nga Berova, Pehçeva, Dellçeva dhe Makedonska Kamenica, madje 70% konsiderojnë që rajoni po lëviz në drejtim të gabuar, ndërsa si arsye kryesore për atë kanë theksuar politikën, mungesën e vendeve të punës dhe mungesa e prosperitetit. Madje gjysma e të anketuarve konsiderojnë që gjendja ekonomike në rajon gjatë 5 viteve të fundit do të keqësohet, dhe vetëm 25% janë optimistë dhe mendojnë që do të përmirësohet. Një e treta e të anketuarve janë përgjigjur që papunësia gjatë 5 viteve të fundit është rritur dukshëm, dhe vetëm 17% mendojnë që është zvogëluar. Në pyetjen se a ka

perspektive në këtë rajon, madje 90% janë përgjigjur që nuk ka, sepse nuk ka punë, nuk ka jetë kulturore, ka punësime sipas partisë, nuk ka investime, nuk ka fabrika, rrogat janë të ultë. Në pyetjen “Çfarë mendoni që do të mbajë të rinjtë që të qëndrojnë në vendlindjen e tyre?”, i kanë theksuar këto pika në vijim: zhvillimi i ekonomisë, puna e mirë dhe rrogë e volitshme, reforma dhe demokraci, rritje të standardit, hapje të fabrikave, punësim sipas profesionit, ndryshim të gjithë sistemit. Turizmi, si një prej sektorëve që nuk është përdorur tërësisht, mund të përgjigjet sfidave të caktuara me të cilat përballohet rajoni.

Në fakt, në Strategjinë për Zhvillimin e turizmit në Rajonin Lindor të Planifikimit me plan veprimi (2015-2024) theksohet që zhvillimi i turizmit ka një rëndësi të madhe për rajonin sepse mund të punësojë shumë persona. Megjithatë, shqetëson fakti që struktura e moshës së popullatës, gjithnjë e më tepër, dominon popullata më e moshuar prej mbi 65 vjeç, në krahasim me popullatën e re. Arsye për rritjen e mesatares së moshës, përveç natalitetit të ultë, është edhe migracioni i popullatës së re nga rajoni për në Shkup dhe jashtë shtetit (kryesisht për shkak të nevojave ekonomike). Nëse përforcohen veprimet ekonomike të rajonit, pritet që ky trend të zvogëlohet, madje edhe të qëndrojë në vend. Turizmi duhet të jep një impuls solid në këtë drejtim.

Turizmi si sektor është i orientuar drejt klientëve dhe është drejtuar për grupet e ndryshme, dhe efektet prej këtu mund të jenë edhe ato të eksportit. Përveç infrastrukturës ekzistuese dhe ofertës, turizmi është i varur edhe bashkëpunimi me partnerë jashtë rajonit si dhe me partnerë të huaj. Një prej problemeve me të cilat përballohemi është që në rajon nuk ka informacion për numrin e saktë të vizitorëve, gjegjësisht nuk ka mekanizëm për të ndjekur këtë dukuri. Gjithashtu, problem paraqet edhe fakti që nuk ka kategorizim të komplekseve turistike dhe nuk ka ofertë të zhvilluar turistike për të tërhequr më tepër vizitorë.

Ky rajon nga pjesa lindore kufizohet me R. e Bullgarisë, ndërsa komunikimi me shtetin fqinj zhvillohet me anë të kalimit kufitar Dellçevë në komunën e Dellçevës. Ka mundësi për aktivizim të kalimeve Klepalo, shumë shpejtë, si dhe Ajdutska Çeshma dhe Crna Skala në afatin më të gjatë. Në periudhën e fundit, në trend janë vizitat njëditore ose dyditore të turistëve nga Bullgaria, kryesisht të Dellçevës për shkak të ditës për pazar dhe blerje. Duhet të bëhet qasje për ofertë të përmbajtjeve plotësuese që do të ofrojnë qëndrim më të gjatë me përmbajtje të reja dhe interesante, si dhe tërheqjen e turistëve të rinj. Në këtë drejtim, gjatë viteve të fundit, në mënyrë intensive punohet në zhvillimin e vendbanimeve turistike në tre komunat: Liqeni i Berovës, Suvî Laki, Ravna Reka dhe Gollak, me ndërtimin e rrugëve me asfalt, infrastrukturë dhe përmbajtje të reja siç janë shtigje për biçikletë, shtigje edukative për fëmijë, shtigje të llojllojshmërisë biologjike, etj. Një përmbajtje tjetër që jep potenciale për periudhën vijuese është Qendra Edukative për Ruajtjen e natyrës në f. Negrevë.

DREJTIME DHE REKOMANDIME

Në dokumentet strategjike të komunave Berovë, Dellçevë dhe Pehçevë (Strategjia për Zhvillim Lokal Ekonomik të komunës Berovë (2014-2019), Strategjia për Zhvillim të Turizmit Lokal në komunën Pehçevë (2018-2023), si dhe Strategjia për Zhvillim të Mjedisit Rural të Grupit Lokal të Aksionit “Malesh-Pijanec” (2018-2022), një prej **prioriteteve për zhvillim të rajonit është turizmi**. Duke vlerësuar që kjo degë ka potenciale të vërteta për zhvillim dhe mund të jetë një prej sektorëve kryesor në zhvillimin lokal ekonomik, investohen përpjekje të shumta për rritjen e ofertës turistike.

Si drejtime kryesore për zhvillim të turizmit në rajonin Malesh-Pijanec i veçojmë këto në vijim:

- Duhet të bëhen **regjistra të kapaciteteve të akomodimit**, për të cilët do të jenë përgjegjës qendrat informative turistike në kuadër të komunave dhe do të mbajnë **statistikë të rregullt** për vizitorët, si dhe interesat dhe kërkesat e tyre. Kjo do të krijojë bazë për analiza të bazuar në të dhëna, dhe do të kontribuojë për planifikimin e pakove turistike të synuar për grupet e ndryshme të interesit dhe me përmbajtje përkatëse.
- Duhet **rrjetëzim dhe bashkëpunim të ngushtë të palëve të interesuara** (komuna, hotele, restorante, ferma, kopshte, shëtitës malor, mbledhës/përpunues të frutave të egër malore, shoqata, etj.), si dhe agjenci turistike për turizëm dhe operatorë të turneve) dhe krijimi i **ofertës së integruar turistike** që do të bashkojë përmbajtjet e ndryshme dhe do të ofrojë programe të ndryshme për qëndrim të disa ditëve. Si mundësi mund të ofrohen **pako turistike** të ndryshme, me përqendrim për grupe të ndryshme synimi (p.sh. turizëm familjar, kampe për fëmijë, konferenca, etj.).
- Për një histori të suksesshme të kësaj pjese, duhet edhe **mirëmbajtje të rregullt të kapaciteteve dhe atraksioneve aktuale**.
- Duhet edukim i vazhdueshëm dhe **përforsim të kapaciteteve njerëzore** të përfshirë në biznesin e turizmit, si në lidhje me aspektet turistike dhe hotelierike, ashtu edhe në kuptim të përgatitjes dhe kompetencës për përdorim të suksesshëm dhe efikas të fondeve të ndryshme që kanë të bëjnë me zhvillimi në mjediset rurale dhe infrastrukturë rurale (fonde kombëtare, IPARD2, bashkëpunim ndërkuftar, etj.).
- Në pjesën e promovimit të **ushqimit tradicional**, duhet gjithashtu një qasje sistematike. Këtu, duhet në mënyrë më intensive të mendohet rreth mbrojtjes së produkteve bujqësore dhe ushqyese me shenjë origjinës, shenjë gjeografike ose shenjë për specialitet të garantuar tradicional.
- Gjithashtu, në lidhje me **bimës shëruese dhe frutat malore**, duhet një **edukim për mbledhjen e tyre të drejtë** dhe të përcaktohen sasi për përdorimin e tyre të qëndrueshme. Kjo hap mundësi plotësuese për kyçje të këtij aktiviteti në ofertën turistike.
- Duhet të bëhet një kornizë për mbështetjen përkatëse dhe **promovimin e ofertës së pasuruar turistike**.

KONKLUZION

Trendët e zhvillimit të turizmit janë në drejtim të përjetimit specifik që do të ofrohet vizitorëve. Rajoni Malesh-Pijanec pa dyshim që ngadalë po bëhet një destinacion turistik atraktiv, si për

vizitorët vendor ashtu edhe për të huajt. Njohja bëhet kryesisht për shkak të bukurive natyrore, mjedis jetësor të pa ndotur dhe ushqim i shëndetshëm tradicional, që ofron ky vend vizitorëve si dhe përmbajtjet për qëndrim aktiv në natyrë.

Megjithatë, rajoni për një kohë të gjatë përballohet me migracionin e popullatës në qytetet më të mëdha brenda vendit dhe jashtë, si rezultat i shumë faktorëve, mes të cilëve edhe mundësitë e kufizuar për punësim, të ardhurat e ultë dhe jeta e dobët kulturore (Hulumtimi i Shoqatës Ambrozija, 2016). Në këtë drejtim, zhvillimi i turizmit mund për shumë të ndryshojë gjendjet në lidhje me përmirësimin e kushteve ekonomike në rajon dhe cilësinë e jetës së popullatës lokale.

Për të përdorur potencialet, duhet të vendoset theks mbi aktivitete të caktuar që do të kontribuojnë për zhvillimin e turizmit në rajonin Malesh-Pijanec. Në këtë dokument të shkurtë, si më të rëndësishëm, i theksojmë këto në vijim: hartimi dhe azhurnimi i regjistrave për kapacitetet e akomodimit dhe kategorizim të kapaciteteve private të akomodimit; përgatitje të ofertës së integruar turistike dhe përpunimi i pakove të ndryshme turistike; përforcimi i kapaciteteve njerëzore në sektorin turistike me anë të trajnimit dhe arsimit; trajnim për përgatitjen e projekteve mbi përdorimin e fondeve në dispozicion; vlerësim i sasive për përdorim të qëndrueshëm të bimëve shëruese dhe frutave malore dhe edukimi për mbledhjen e drejtë; mirëmbajtja e kapaciteteve aktuale dhe atraksioneve turistike.

BURIMET

Milevski, I., Tuntev, Z., Ruzhin, I., Jankova, V., Vrteski, J., Naumoski, Z. (2016) Studimi për gjendjen me potencialet për zhvillimin e turizmit në Rajonin Lindor të Planifikimit. Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), Helvetas Swiss Intercooperation dhe Farmahem.

Milevski, I., Tuntev, Z., Ruzhin, I. (2016) Studimi për gjendjen me potencialet për zhvillimin e turizmit në Rajonin Lindor të Planifikimit me Plan Veprimi (2015-2024). Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), Helvetas Swiss Intercooperation dhe Farmahem.

Komuna e Berovës (2014) Strategjia për Zhvillim Lokal Ekonomik e Komunës së Berovës (2014-2019)

Komuna e Pehçevës (2017) Strategjia për Zhvillim Lokal Ekonomik e Komunës së Pehçevës (2018-2023)

GLA “Malesh-Pijanec” (2016) Strategjia për Zhvillimin e Mjedisit Rural të Grupit Lokal të Aksionit “Malesh-Pijanec” (2018-2022).

Shoqata për Bimë Shëruese dhe Fruta Malore Ambrozija (2016) Me anë të veprimit të integruar deri tek ulje të migracionit, hulumtim.

INFORMACIONE PLOTËSUESE

Shoqata – Qendra për Bimë Shëruese dhe Fruta Malore “Ambrozija” – Pehçevë

rr. “Ilindenska” nr. 18, Pehçevë

Tel: 072 321 848

e-mail: centar.ambrozija@gmail.com

Shoqata “Qendra Edukative për Ruajtjen e Natyrës” – f. Negrevë, Pehçevë

Tel: 075 462 592

e-mail: edukativenc.negrevo@gmail.com

Organizata e Grave të Komunës së Pehçevës (OGP)

rr. “Boris Kidriç” pn Pehçevë

e-mail: oozpehcevo@yahoo.com